

## Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

**Grupi i Punës II (Drejtësia, Liria, Siguria)**  
**Sesioni 1, Tema: Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe tregtare**  
**27 maj 2022, 10:00 – 12:00**

### REKOMANDIME

- Promovimi i parimit të meritokracisë për personelin e administratës gjyqësore dhe të magjistratëve (si gjyqtarë e prokurorë). Për këtë duhen vendosur kritere gjithëpërfshirëse por edhe të mirëpërcaktuara që procesi të jetë sa më i drejtë, objektiv dhe i gjithanshëm.
- Duhet të ketë një fokus të veçantë në kurrikulat dhe përgatitjen e aftësive intelektuale në planin e formimit në universitet por edhe në shkollën e Avokatisë dhe Magjistraturës. Me Reformën në Drejtësi janë vënë re disa zhvillime pozitive në këtë drejtim por duhet më shumë punë në ngritjen e nivelit të stafeve akademike dhe përgatitjen e përgjithshme që marrin studentët, të cilët janë juristët dhe magjistratët e ardhshëm.
- Reforma në Drejtësi dhe procesi i vetingut (rivlerësimi i magjistratëve) ka krijuar në sistemin e drejtësisë boshllëqe të mëdha për shkak të largimit të shumë magjistratëve. Për këtë përgatitja sa më parë e sa më shumë magjistratëve të rinj vjen si domosdoshmëri për shkak të këtyre hapësirave të krijuara. Por nga ana tjetër nuk mund të bëhet kompromis me cilësinë dhe procesin e përgatitjes dhe kualifikimit të këtyre magjistratëve në mënyrë sa më rigorozë dhe duke respektuar të gjithë fazat e procesit, me justifikimin që duhet të plotësohen hapësirat e krijuara prej vetingut.

- Reforma në Drejtësi për arritjen e një prej qëllimeve dhe objektivave siç është pavarësia e gjyqësorit e kombinuar me transparencën dhe përgjegjshmërinë. Pavarësisht arritjeve të deritanishme është e rëndësishme që mekanizmat e krijuar për të ruajtur këtë pavarësi të gjyqësorit nga politika të jenë sa më të qëndrueshme dhe të ndërmerren masa që aktorët e përfshirë të jenë sa më të qartë dhe të informuar mbi këto mekanizma dhe funksionimin sa më të mirë të tyre.
- Me rëndësi është dhe vazhdimi i punës për procesin e transpozimit të legjislacionit në këtë fushë, me fokus dhe ratifikimin e të gjithë traktateve të miratuara në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor. Gjithashtu sugjerohet duke qenë që konsiderohet si problematike zbatimi në kohën e duhur të marrëveshjeve ndërkombëtare të miratuara.
- Për zbatimin sa më efektiv të këtij legjislacioni rekomandohen që të realizohen sesione informimi dhe trajnimi me institucionet dhe aktorët përgjegjës duke përfshirë ekspertë kombëtarë dhe evropianë dhe duke promovuar bashkëpunimin institucional dhe atë të sistemit të drejtësisë me sektorë të tjerë si universitetet apo sektori i shoqërisë civile, që mund të ofrojnë ekspertizë dhe *know-how* në fusha e çështje të tilla.
- Shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave më të mira me vende të rajonit dhe Shtetet Anëtare të BE-së duhet të promovohen nga strukturat përgjegjëse nëpërmjet projekteve të përbashkëta apo aktiviteteve të tjera me fokus ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e bashkëpunimit gjyqësor.